



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

Kryetari i Komunës.

Nr. _____ . Data: 19.01.2024.

Mitrovicë Veriore.

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, dhe nenin 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

V E N D I M

(Për emërimin e Zyrtarës Përgjegjëse për Koordinimin e Procesit të Konsultimit Publik)

1. **Emërohet** znj. Myrvete Ramaxhiku, Zyrtare Përgjegjëse për Koordinimin e Procesit të Konsultimit Publik për Komunën e Mitrovicës Veriore.
2. Zyrtarja e emëruar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi është e obliguar që të bëjë përgaditjen e formularëve shpjegues të projekt-propozimit për konsultim publik dhe dokumentacionit përcjellës, koordinimin e konsultimit publik në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për përgaditjen e Draftit fillestar të Projekt-Propozimit dhe Grupin Punues, përcjelljen e afateve kohore për procesin e Konsultimit Publik dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tjera konform dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.
3. Zyrtarja përgjegjëse obligohet që të përgatisë raporte vjetore për procesin e Konsultimit Publik në Komunë dhe për të njëjtat raporton tek Kryetari i Komunës dhe në Njësinë Përgjegjëse për Monitorim të Komunave në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Në rast të mungesës së Zyrtarës të emëruar për koordinimin e procesit të Konsultimit Publik, kompetente është Zyra për Informim.
5. Mandati i Zyrtarës së emëruar është një (1) vit me mundësi vazhdimi
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Erden ATIQ

Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore



I dorëzohet:

1x1 Kryetarit

1x1 Zyrës ligjore

1x1 Zyrës së Informimit

1x1 znj. Myrvete Ramaxhiku

1x1 Arkivit